



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 39/6 prot.

Tiranë, më 05.09.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1676, datë 06.09.2013.

**SHOQËRISË “QERAMIKA ALBANIA” SH.P.K
Rruga Nacionale Korçë – Ersekë, Km 4, Korçë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT
NË MINIERA
Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Qeramika Albania” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1676, datë 06.09.2013, për mineral argjilë, në objektin “Mollas”, Korçë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.437, datë 14.01.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.541/1, datë 15.01.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.1676, datë 06.09.2013, për mineral argjilë, në objektin “Mollas”, Korçë, për shkak se nuk është bërë pagesa e garancisë mjedisore për vitin 2018 – 2019.

Gjithashtu me shkresën e strukturës përgjegjëse të AKBN-së nr.444, datë 14.01.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.530, datë 15.01.2019, është propozuar pezullimi i aktivitetit minerar për lejen minerare në fjalë, sepse nuk ka dorëzuar për miratim planin vjetor të punës për vitin 2018 – 2019, duke shkelur germenin “ç”, të nenit 25, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germenin “ç” dhe “g”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1676, datë 06.09.2013, për mineral argjilë, në objektin “Mollas”, Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1676, datë 06.09.2013, për mineral argjilë, në objektin “Mollas”, Korçë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

